



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA PUKE
KËSHILLI BASHKIAK

Nr: 1875/prot

Pukë, më 22.10.2024

VENDIM

NR. 49 datë 16.10.2024

“PËR RISHQYRTIMIN E VKB NR. 22 DATE 29.05.2024 “ PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË VKB NR.16 DATE 05.05.2022” “PËR DHENIEN E DAKORTESISË PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE TË HEQJES NGA FONDI PYJOR/KULLOSOR PUBLIK PËR 0.02 HA PËR NDËRTIMIN E IMPJANTIT GJENERUES TË ENERGJISË ELEKTRIKE EOLIKE 2MW NGA SHOQERIA “DEMBACAJ 2020” SH.P.K”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpikat 1.1 shkronja “b” dhe 1.2, shkronjat “a” dhe “c”, nenit 54, shkronja “e”, nenit 55, pikat 3 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjin nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Ligjin nr.107/2014 datë 31.07.2014 “Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, në Ligjin nr.43 date 30.04.2015 “Per sektorin e energjisë elektrike ” i ndryshuar , në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr. 433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të fondit pyjor e kullor publik.”, V.K.M-ve nr. 888, datë 27.12.2022, “Për rastet e dhenjes në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit , procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimin e sipërfaqeve dhe paksimin në volum nga fondi pyjor kombëtar, apo zgjerimin e tyre; VKM-ve nr. 559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e cmimeve tarifave për dhenjen në shfrytëzim/Përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore 1374, date 10.10.2008 “Per përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor” Udhezimin e Ministrisë të Mjedisit Nr. 1 date 09.06.2016 “Per rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit të miratimit të kërkesave për dhenje në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, nga Drejtoria Përgjegjëse për pyjet dhe Kullotat , me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak pas shqyrtimit dhe diskutimit të anëtarëve :

VENDOSI:

1. Të bëhet ndryshimi në pikën 1 të vendimit nr.16 datë 05.05.2022 si më poshtë:
“Të shprehë dakortësinë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor/ kullor publik për ndërtimin e impjantit gjenerues të energjisë elektrike eolike 2MW të sipërfaqes prej 0.02 ha, pasuri Nr.424 vol.2 faq.195 zona kadastra 2992 që ndodhen në ngastrën 23 në ekonomine “Gomsiqe” në pronësi të Bashkisë Pukë”
2. Në pikën 2 të vendimit Nr.16 date 05.05.2022 shtohet pika 2.1 dhe 2.2 si më poshtë:

2.1 Të miratojë dhenjen në përdorim me kontratë qeraje të sipërfaqjes pyjore me gjatësi lineare 8.532 km “Për ndërtimin e linjës elektrike 35 KV” nga fshati Kçirë deri në qytetin e Pukës me afatë 10 vjeçarë.

Parcela Nr.	Pasuria Nr.	Vol. Nr.	Faqe	Zona kadastrale	Ekonomia Pyjore
8/a	121	6	232	3070	Gomsiqe
8/b	1209	7	14	3070	
12	426	2	198	2992	
13/b	428	3	174	2992	
20	425	2	196	2992	
23	424	2	195	2992	
139/b	1113	6	101	3070	
60/a	684/1	3	233	2509	Terbun
60/b	689	3	120	2509	
61/a	688	3	216	2509	
61/c	685	3	236	2509	

- 2.2 Vlera vjetore e dhënjes me qera të jetë sipas studimit teknio-ekonomik dhe bazuar në VKM nr. 559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve, tarifave për dhënjen në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore.
3. Për vazhdimin e procedurave sipas përcaktimeve të Udhezimit nr 1/2016 të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit ngarkohet Struktura Përgjegjëse për pyjet dhe Kullotat në Bashkinë Pukë, zyra kadastrës pyjore,
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Drejtori i Menaxhimit të Pyjeve, Kullotave dhe Bujqësisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes, sipas ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 55, pika 6.
6. Vendimi u shpall me date 18.10.2024.
 Vota të vlefshme gjithsej 12
 Vota pro 9, vota kundër 0, vota abstenim 3

SEKRETARI
 Hazbi Terbuni

KRYETARI
 Gjon GJOKA





04.11.24

sek / sh. H. Ventury



1875/3
04.11.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 732/1 Prot.

Shkodër, më 04.11.2024

Lënda: Kërkesë për plotësim dokumentacioni mbi Vendimin nr. 49, datë 16.10.2024

KËSHILLI BASHKIAK PUKË

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", i ndryshuar, neni 56, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 9, pika 1.2, shkronja "a", neni 27, pika 5, neni 54, shkronja "e/1", neni 55, pika 3 dhe 4, të ligjit nr. 57/2020 "Për pyjet", neni 25, të VKM nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin ne pronesi te bashkive te pyjeve dhe te kullotave publike, sipas listave te inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive", të ndryshuar, pika 50, shtojca 48, të VKM nr. 559, date 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike si dhe prodhime drusore dhe jodrusore pyjore", lidhja 1, tabela 13, të VKM nr. 888, datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjo kombëtar apo zgjerimin e tyre", të Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit nr. 1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", pikat 7, 8 dhe 22, shqyrtoi VKB Pukë nr. 49, datë 16.10.2024 "Për rishqyrtimin e VKB nr. 22, datë 29.05.2024, për një shtesë dhe ndryshim ne VKB nr. 16, datë 05.05.2022 për korrigjimin e gabimit në përcaktimin e parcelës ku do të ndërtohet impianti gjenerues të energjisë elektrike eolike 2MW, si dhe një shtesë në vendim dhënie në përdorim me kontratë qeraje të sipërfaqes pyjore me gjatësi lineare 8.532 km për ndërtimin e linjës elektrike 35 KV nga shoqëria "Dembacaj 2020" sh.p.k."

Për sa trajtuar, Prefektit në zbatim të kompetencave të përcaktuara nga Urdhëri i Ministrit të Brëndshëm nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe Aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", neni 4, pika 1, shkronja "b", kërkon plotësimin e vendimarrjes me statusin juridik të pronës.
Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGOZI

